REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E ARSIMIT, PARASHKOLLOR,RINISE DHE SPORTIT

Nr._____Prot . **Bilisht, më / /2026**

PROJEKT-VENDIM
NR 61 /DATË 17 /07 /2026

PËR
"DHENIEN E TITULLIT QYTETAR NDERI PER Z. ZAMIR DULE"

Në mbështetje të nenit 54 germa "m" të Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ", Ligjit Nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Vendimi nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesës të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendor të Nderit.

PROPOZOJ

1.Dhenien e titullit "**Qytetar Nderi"** , për z. **ZAMIR DULE** .

2.Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Komisioni Keshillimor per Medaljet dhe Titujt Vendor te Nderit ne Bashkine Devoll.

3.Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139 data 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Konceptoi :
Drejtor i Drejtorisë të Arsimit Parashkollor,Rinisë dhe Sportit.
E.Pavliqoti

Konfirmoi bazën ligjore:Specialist jurist
J.Sancolli

Konfirmoi Sekretari i Përgjithshëm:
A. Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

BASHKIA DEVOLL REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Adresa: LagjaNr. 1, Rr. 24 TetoriNr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E ARSIMIT, PARASHKOLLOR,RINISE DHE SPORTIT

Nr 282**prot** **Bilisht,** 16 /07/ **2026**

RELACION

"Për dhenien e Titullit **QYTETAR NDERI** per z. **ZAMIR DULE "** (pas vdekjes) me motivacionin :"**Per kontributin e dhene ne gazetarine shqiptare pas viteve 1990**"

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Devoll.

Te nderuar anetare te Keshillit Bashkiak:

Komisioni Keshillimor per Medaljet dhe Titujt Vendor te Nderit , i ngritur ne baze te Urdhrit te Kryetarit e Bashkise Devoll me nr 522 date 02.10.2025 dhe protokolluar me nr 3165 prot date 02.10.2025, beri takim me date 08.05.2026 per te shqyrtuar kerkesen e keshillit bashkiak me nr 976/1 date 29.04.2026 . Ne kete takim , kryetari i Komisioni Z. Nardi Hoxha i beri te ditur Komisionit kerkesen e dorezuar nga anetari i Keshillit zj.Lindita Çokani .me lende 'Propozim per shpalljen "Qytetar Nderi (pas vdekjes) te gazetarit Zamir Dule" Meqenese nga anetaret e Komisionit u kerkuan dokumenta shtese dhe konkretisht **: Verifikimin e figures te kandidatit per kete Titull** , mbledhja u shty ne nje afat deri sa te kthehej pergjigja nga Autoriteti per Informin mbi Dokumentat e ish Sigurimit te Shtetit. Bashkia Devoll me shkresen nr 1733/1 prot date 13.05.2026 ka kerkuar informacion per shtetasin Z.Zamir Dule prane Autoritetit per Informin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit te Shtetit. Ne date 26.06.2026 ne takimin e radhes te Komisionit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur nga ky Institucion i ardhur te ne me nr 1763/3 prot date 24.06.2026 dhe te tyren me nr 11203/3 prot date 22.06.2026. Ne takim ishin pjesemarres te gjithe anetaret e Komisioni te cilet dhane opinionin e vet ne baze te dokumentacionit qe kishin ne dispozicion. Ne perfundim te mbledhjes te gjithe anetaret e Komisionit ishin te mendimit pro duke miratuar propozimin per dhenien e titullit qytetar nderi per z.Zamir Dule duke argumentuar se e meriton kete titull vendor nderi per shkak te veprimtarise të shquar, kontributeve dhe meritave të veçanta.

Bashkengjitur ketij relacioni keni gjithe materialet qe permendem me lart.

Ftojme te gjithe anetaret e Keshillit Bashkiak te gjykojne dhe te vendosim ne baze te detyres qe i ngarkon Ligjit te miratojne ose jo kete Projekt-Vendim te propozuar nga Drejtoria e Arsimit Parashkollor, Rinise dhe Sporteve , ne baze te kerkeses te depozituar ne protokoll.

Konceptoi :Drejtore e Drejtorise te Arsimit Parashkollor Rinise dhe Sportit
E.Pavliqoti

Adresa: LagjaNr. 1, Rr. 24 TetoriNr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

Dibër, 26.6.2026

Komisioni Këshillimor
për Medaljet dhe Titujt
Vendor të Ndërt në Bashkinë Dibër

Proces - Verbal

I mbajtur sot më datë 26.6.2026 për verifikimin e figurës të 2. Samir Dule.
të pranishëm në mbledhje janë 2. Nardi Hoxha, 2. Oliver Topçiu, 2vj. Elisveta Parligoti, 2vj. Ornela Shuleku.
të mbledhjen e datës 08.05.2026, Komisioni Këshillimor endosi të këtheje para Autoritetit për Informim, informacion se kandidati i propozuar për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për 2. Samir Dule ka qenë bashkëpunëtor me Sigurimin Shtetit.
Me shkresën numër 1120/3 prot datë 22.06.2026 të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit protokolluar me numër 1763 prot datë 24.06.2026, Komisioni Këshillimor u njoh me Vendimin Nr. 316 datë 18.06.26 pas Vendimit të mësipërm rezulton se kandidati i propozuar dhënien e titullit "Qytetar Nderi" 2. Samir Dule, në qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i [illegible] të Partisë së Punës së Shqipërisë, anëtar i

Kryetarit të Kuvendit Popullor, Ligjëruar: Gjykatës së Lartë Prokuror i Përgjithshëm, Ligjëruar: Ekzekutivi së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, Ligjëruar: dëgjve të pranë të Arsimit, anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Ligjëruar, prokuror, gjyqtar në procese të posaçme politike a rrugës i nivelit të lartë i Sh- Sigurimit të Shtetit. Ish ka qenë bashkëpunëtor i Sh- Sigurimit të Shtetit si ne nuk ka qenë person me të dhëna nga Sh- Sigurimi Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

Deputetët Vendimit të rëndësishëm figura e D. Zamir Dule është e pastër si dhe anëtarët e komisionit janë gjyqtar - gjetën dhe verifikimin e kandidatit.

Nëse të gjithë anëtarët të Asaj opinionet e tyre ku me propozimin për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" kandidatin D. Zamir Dule. Rekomandimet e marra prej do të përcillen Autoritetit Përgjegjës për dhënien e titullit "Qytetar Nderi".

Iver Topçiu:

Ky vendimit tim, pasi u njoftën dhe me Vendimin e votimit për informin ku figura e kandidatit të pozuar rezulton që nuk ka qenë bashkëpunëtor i Sh- Sigurimit të Shtetit dhe pësa i tëlon kontributit të tij Kuvendin e arsyetimit dhe figurës së tij si qytetar i zonës

- Deri në fund, sakrificës dhe dëshirës për të dhënë kontributin për ngritjen paraqitjen përndryshe të veçantë që ka pasur, pranë të pakuptueshmes dhe në ekuilibrin në kujtimin dhe realizimin - dhimbje të ndryshme të cilat tregojnë realitetin e koklës, am Pro dhënies të titullit "Qytetar Nderi" pas vdekjes

të 2. Zamir Dule.

Oliverta Tyrau.

Riverta Parligoti.

të gjykimin tim 2. Zamir Dule përfaqëson personin i ri nuk u step paraqitë vetëmjaftueshmëri të kohës të ishte zotëri model dhe tregues integriteti në mbrojtjen e të vlerës. Gjatë karrierës së tij si gazetar për shkak të profesionit ai u përball dhe u konfrontua dhe i shkaktuar ndaj në rrezikun e tij fizik dhe mendor. Për të dëmtuar ekën e tij dhe për të rritur kontributin e tij në zotëri gjë dakord të përcillet Autoritetit Përgjegjës për nien e titullit "Qytetar Nderi" për 2. Zamir Dule pas ijës.

Cenaka Dreçeh

nda Kuleshi.

a rekomandimi i figurës të 2. Zamir Dule prej Autoritetit formim dhe nga shqyrtimi i dosjes të dorëzuar pranë risionit konkluduar lidhur me jetën dhe veprimtarinë e Zamir Dule, gjithaj se 2. Zamir Dule referuar jetës

[illegible] dhe mediat, i cili dhe në mënyrë të [illegible]
nuk i dorëzua kurrë por vetëm të ishte zëv. i Kreut
Qëndrimet në botimet e gazetës "Koha jonë". Sipas nejë
shoqërie që të realizojë Arbitrimi Këshillës për Mbrojtje e
titullit "Qytetar Nderi" pas vdekjes për 2. Zanin Dule. Jam Pro

Vardi Hoxha

Figura e 2. Zanin Dule simbolizon në gazetarinë Shqiptare
ën Kidhëse nidis të vërtetës dhe publikut. Ai ka qënë personi
cili simbolizon guximin për të hedhur flogari, në zbulimin
të vërtetave të fshehtësuara për shkak të shkuit të kaluar
ifikare, vrarjes së tij shkuit dhe publikimit të Kurë
prave dhe guximin për të pasqyrë të vërtetën dyft gyetarë
- dhënë që ti përcillet për lirësim Autoritetit Këshillës
- dhënjen e titujve "Qytetar Nderi" për 2. Zanin Dule pa vdekje

- Mbrësimin e ardhurës të komitetit Këshillimor për vepërsinë
ën dhe figurën e 2. Zanin Dule, të cilët idin një zëri
ro. Do mbullin mbledhjen dhe Proces-Verbalet e mbledhjeve

Në bazë të nenit 5 të Kontratës Kolektive të Punës - Vendimit e Këshillit Bashkiak për miratimin e Rregullores për Ofrimin e Ndihmës Ekonomike për Familjet në Nevojë dhe Rregullores për Ofrimin e Ndihmës Ekonomike për Familjet në Nevojë - Vendimin për miratimin e Këshillit Bashkiak për propozimin e Ofrimin e Titullit "Qytetar Nderi" për z. Samir Dule.

Ngritën:

Sekretar

Arkëtar

Fatjon Hoxha

Oliver Topçiu

Eliverda Parllaku

Nr 976 Prot
Dt. 12.03.2026

Drejtuar: Këshillit Bashkiak të Bashkisë Devoll

Lënda: Propozim për shpalljen "Qytetar Nderi (pas vdekjes)" të gazetarit Zamir Dule

I nderuar nj/z- tw Këshillit Bashkiak,

Nëpërmjet kësaj kërkese paraqesim propozimin që gazetari Zamir Dule të nderohet me titullin "Qytetar Nderi (pas vdekjes)" nga Bashkia Devoll, në shenjë vlerësimi për kontributin e tij në gazetarinë shqiptare, për guximin profesional në mbrojtje të së vërtetës dhe për sakrificën e rëndë personale që ai përjetoi gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarit në një nga periudhat më të vështira të tranzicionit demokratik në Shqipëri.

Zamir Dule ishte një nga gazetarët e talentuar që u shfaqën në vitet e para të pluralizmit në Shqipëri. Ai e nisi karrierën e tij në gazetarinë e shkruar në fillim të viteve '90 si korrespondent për qarkun e Korçës i gazetës "Koha Jonë", një nga gazetat më të rëndësishme dhe më të lexuara të asaj periudhe. Për shkak të përkushtimit, profesionalizmit dhe talentit të tij në raportimin e ngjarjeve, në vitin 1994 u thirr në redaksinë qendrore të gazetës në Tiranë për të punuar si reporter i kronikës së zezë.

Në këtë rol ai u dallua për kurajën në raportim, për këmbënguljen në kërkimin e së vërtetës dhe për aftësinë për të trajtuar me profesionalizëm ngjarje të ndjeshme dhe shpeshherë të rrezikshme të kohës. Kolegët e tij e kanë cilësuar si një nga penat më të spikatura të gazetarisë së asaj periudhe dhe si një reporter me pasion të jashtëzakonshëm për profesionin.

Gjatë karrierës së tij, Zamir Dule botoi një sërë shkrimesh publicistike, kronika investiguese, kronika të zeza, shkrime artistike dhe ditarë personalë. Ndër botimet e tij më të njohura është edhe libri "Përbindëshi i Tropojës", një botim kritik që trajtonte zhvillimet politike të kohës dhe që dëshmonte guximin e tij profesional për të trajtuar tema të ndjeshme në një klimë të vështirë për median.

Një nga momentet më dramatike të jetës së tij ndodhi gjatë krizës së vitit 1997 në Shqipëri. Natën e 2 marsit duke u gdhirë 3 marsi 1997, përpara djegies së redaksisë së gazetës "Koha Jonë", gazetari Zamir Dule u mor me forcë nga ambientet e redaksisë së bashku me një punonjës tjetër dhe u dhunua rëndë në qelitë e Komisariatit Nr. 3 të Policisë në Tiranë. Kjo ngjarje tragjike ndodhi në një klimë të tensionuar politike dhe shënoi një nga momentet më të errëta për lirinë e medias në Shqipëri.

Pas kësaj ngjarjeje, Zamir Dule pësoi pasoja të rënda në shëndetin e tij mendor dhe u detyrua të tërhiqej nga gazetaria. Trauma e përjetuar në ato ngjarje ndikoi thellësisht në jetën e tij personale dhe profesionale, duke e detyruar të jetojë për vite me radhë në kushte të vështira dhe në një izolim të dhimbshëm.

Megjithatë, edhe në këto kushte të vështira, ai mbeti i lidhur me leximin, shkrimin dhe reflektimin intelektual. Ai vazhdoi të shkruante në mënyrë sporadike dhe të mbante shënime e reflektime për realitetin shqiptar, duke ruajtur kështu lidhjen e tij shpirtërore me profesionin e gazetarit.

Figura dhe jeta e Zamir Dules janë vlerësuar nga shumë kolegë dhe personalitete të gazetarisë shqiptare. Kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa, në një shkrim përkujtimor për ndarjen e tij nga jeta, e cilësoi Zamir Dulen si një gazetar të lindur dhe një

reporter me talent të veçantë, i cili pagoi një çmim shumë të rëndë për pasionin dhe përkushtimin ndaj profesionit të gazetarit. Sipas tij, jeta e Zamir Dules përbën një histori të dhimbshme, por edhe një simbol të sakrificës së gazetarit në mbrojtje të së vërtetës dhe të lirisë së fjalës.

Në shenjë njohjeje për vuajtjet dhe përndjekjen që përjetoi gjatë ushtrimit të profesionit, qeveria shqiptare pas vitit 1997 i akordoi Zamir Dules një pension të posaçëm, si një formë vlerësimi institucional për kontributin dhe sakrificën e tij në gazetari.

Në vitet e fundit të jetës, ai vuante nga probleme të rënda shëndetësore, përfshirë edhe sëmundje të zemrës. Pavarësisht trajtimeve mjekësore dhe përpjekjeve të familjarëve për ta ndihmuar, gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua dhe ai u nda nga jeta në moshën 55-vjeçare. Në momentet e fundit të jetës, pranë tij qëndruan familjarët e afërt që u kujdesën për të me përkushtim.

Jeta dhe historia e gazetarit Zamir Dule përfaqësojnë jo vetëm fatin tragjik të një gazetari të guximshëm, por edhe një simbol të sakrificës së gazetarëve shqiptarë në mbrojtje të fjalës së lirë gjatë një periudhe të vështirë të historisë së vendit.

Për këto arsye, duke vlerësuar kontributin e tij në gazetarinë shqiptare, guximin qytetar dhe sakrificat e rënda që ai përjetoi gjatë ushtrimit të profesionit, propozojmë që Bashkia Devoll ta nderojë gazetarin Zamir Dule me titullin "Qytetar Nderi (pas vdekjes)", si një akt respekti dhe mirënjohjeje institucionale ndaj figurës dhe historisë së tij.

Ky vlerësim do të përbënte jo vetëm një nderim për figurën e Zamir Dules, por edhe një mesazh të rëndësishëm për ruajtjen e kujtesës historike dhe për respektimin e lirisë së medias dhe të fjalës së lirë në shoqërinë demokratike.

Bashkëngjitur kësaj kërkese paraqiten artikuj, dëshmi dhe materiale mediatike që dokumentojnë jetën, veprimtarinë dhe vuajtjet e gazetarit Zamir Dule.

Me respekt,

[Emri / Emrat e propozuesve]
[Adresa / Kontakti]
[Data]

Lindita Çokani

LÇ

ARSYETIM PËR DHËNIEN E TITULLIT
"QYTETAR NDERI (PAS VDEKJES)"
PËR GAZETARIN ZAMIR DULE

Propozimi për shpalljen "Qytetar Nderi (pas vdekjes)" të gazetarit Zamir Dule mbështetet në këto arsye dhe vlera themelore:

1. **Kontribut i rëndësishëm në gazetarinë shqiptare pas viteve '90**
   Zamir Dule ishte një ndër reporterët e talentuar të gazetarisë shqiptare në periudhën e parë të pluralizmit. Ai kontribuoi si korrespondent për qarkun e Korçës dhe më pas si reporter në redaksinë qendrore të gazetës "Koha Jonë", duke u dalluar për profesionalizëm, përkushtim dhe pasion për raportimin e ngjarjeve me interes publik.
2. **Guxim profesional dhe integritet në mbrojtje të së vërtetës**
   Gjatë aktivitetit të tij si gazetar, Zamir Dule u dallua për kurajën në trajtimin e temave të ndjeshme dhe për qëndrimin kritik ndaj zhvillimeve politike dhe shoqërore të kohës. Ai ishte ndër gazetarët që guxuan të trajtonin tema të vështira dhe të shkruanin analiza kritike në një klimë të tensionuar për median e lirë.
3. **Sakrificë personale për shkak të profesionit të gazetarit**
   Gjatë krizës së vitit 1997 në Shqipëri, ai u dhunua rëndë pas marrjes me forcë nga ambientet e redaksisë së gazetës "Koha Jonë", një ngjarje që shënoi një nga momentet më të errëta për lirinë e medias në vend. Pas kësaj ngjarjeje, Zamir Dule pësoi pasoja të rënda në shëndetin e tij mendor dhe u detyrua të tërhiqej nga gazetaria.
4. **Simbol i sakrificës së gazetarit për lirinë e fjalës**
   Historia e jetës së Zamir Dules përfaqëson një shembull të dhimbshëm, por domethënës, të sakrificës së gazetarit në mbrojtje të së vërtetës dhe të lirisë së medias gjatë një periudhe të vështirë të tranzicionit demokratik në Shqipëri.
5. **Vlerësim institucional për kontributin dhe vuajtjet e tij**
   Në shenjë njohjeje për kontributin dhe përndjekjen që përjetoi gjatë ushtrimit të profesionit, qeveria shqiptare pas vitit 1997 i akordoi një pension të posaçëm, si një formë vlerësimi për sakrificat dhe vuajtjet e tij.
6. **Rëndësia e ruajtjes së kujtesës historike dhe nderimit të figurave që kanë kontribuar për shoqërinë**
   Shpallja e Zamir Dules "Qytetar Nderi (pas vdekjes)" do të përbënte një akt të rëndësishëm institucional për ruajtjen e kujtesës historike dhe për nderimin e figurave që kanë kontribuar me integritet dhe sakrificë në jetën publike dhe në zhvillimin demokratik të vendit.

Për këto arsye, vlerësojmë se figura dhe historia e gazetarit Zamir Dule meriton nderimin me titullin "Qytetar Nderi (pas vdekjes)" nga Bashkia Devoll.

2. BIOGRAFIA E GAZETARIT ZAMIR DULE

Zamir Dule ishte një nga gazetarët e talentuar të gazetarisë shqiptare në vitet e para të pluralizmit. Ai e nisi karrierën si korrespondent për qarkun e Korçës i gazetës "Koha Jonë", një nga gazetat më të rëndësishme dhe më të lexuara të viteve '90 në Shqipëri.

Falë profesionalizmit dhe talentit të tij, në vitin 1994 u afrua në redaksinë qendrore të gazetës në Tiranë si reporter i kronikës së zezë. Në këtë rol ai u dallua për guximin në raportim, përkushtimin ndaj së vërtetës dhe aftësinë për të trajtuar ngjarje të ndjeshme dhe shpeshherë të rrezikshme të kohës.

Gjatë aktivitetit të tij profesional ai botoi një sërë shkrimesh publicistike, kronika investigative, kronika të zeza, shkrime artistike dhe ditarë personalë. Ndër botimet e tij më të njohura është libri "Përbindëshi i Tropojës", një botim kritik që trajtonte zhvillimet politike të kohës.

Ngjarja më tragjike në jetën e tij ndodhi gjatë krizës së vitit 1997 në Shqipëri. Natën e 2 marsit duke u gdhirë 3 marsi 1997, përpara djegies së redaksisë së gazetës "Koha Jonë", Zamir Dule u mor me forcë nga ambientet e redaksisë dhe u dhunua rëndë në qelitë e Komisariatit Nr.3 të Policisë në Tiranë.

Pas kësaj ngjarjeje ai pësoi pasoja të rënda në shëndetin e tij mendor dhe u detyrua të tërhiqej nga gazetaria. Trauma e përjetuar ndikoi thellësisht në jetën e tij, duke e detyruar të jetojë për vite me radhë në kushte të vështira dhe në një izolim të dhimbshëm.

Në shenjë njohjeje për vuajtjet dhe sakrificën e tij, qeveria shqiptare pas vitit 1997 i akordoi një pension të posaçëm.

KRONOLOGJIA E NGJARJEVE
2–3 MARS 1997
Dhuna ndaj gazetarit Zamir Dule

Kjo kronologji paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe dokumentare ngjarjet që lidhen me dhunimin e gazetarit Zamir Dule gjatë krizës politike dhe sociale që përfshiu Shqipërinë në vitin 1997.

Shkurt 1997
Shqipëria përfshihet nga një krizë e rëndë politike dhe sociale pas rënies së skemave piramidale. Në shumë qytete të vendit zhvillohen protesta dhe trazira. Media e kohës raportonte intensivisht mbi situatën, ndërsa gazetarët përballeshin shpesh me presione dhe rreziqe gjatë ushtrimit të profesionit.

Fillimi i marsit 1997
Situata në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit tensionohet ndjeshëm. Gazeta "Koha Jonë",

një nga mediat më kritike të kohës ndaj qeverisë, ishte nën presion të vazhdueshëm politik dhe institucional.

2 mars 1997 – mbrëmje
Në ambientet e redaksisë së gazetës "Koha Jonë" në Tiranë ndodheshin disa gazetarë dhe punonjës të redaksisë, ndër ta edhe gazetari Zamir Dule, i cili punonte si reporter i kronikës së zezë.

Natën e 2 marsit duke u gdhirë 3 marsi 1997
Forca policore ndërhyjnë në ambientet e redaksisë. Zamir Dule merret me forcë dhe shoqërohet në Komisariatin Nr. 3 të Policisë në Tiranë.

3 mars 1997 – orët e para të mëngjesit
Në ambientet e komisariatit, Zamir Dule i nënshtrohet dhunës fizike dhe psikologjike. Sipas dëshmive të mëvonshme, ai u rrah rëndë dhe u trajtua në mënyrë çnjerëzore gjatë qëndrimit në qelitë e policisë.

Pas disa orësh ndalimi dhe dhune, ai lirohet në gjendje të rëndë fizike dhe psikologjike.

3 mars 1997 – mëngjes
Pak orë pas këtyre ngjarjeve, godina e redaksisë së gazetës "Koha Jonë" digjet gjatë trazirave që përfshijnë kryeqytetin.

Pasojat
Dhuna e ushtruar ndaj gazetarit Zamir Dule pati pasoja të rënda në shëndetin e tij. Ai pësoi trauma të forta psikologjike dhe probleme serioze shëndetësore që ndikuan drejtpërdrejt në jetën dhe karrierën e tij profesionale.

Si pasojë e gjendjes shëndetësore, ai u detyrua të largohej nga gazetaria dhe për shumë vite jetoi me pasoja të rënda fizike dhe psikologjike.

Vlerësimi institucional
Pas ndryshimeve politike në Shqipëri, institucionet shtetërore njohën vuajtjet e tij dhe i akorduan një pension të posaçëm si formë mbështetjeje.

Historia e Zamir Dules mbetet një nga episodet më të dhimbshme të dhunës ndaj gazetarëve në vitet e tranzicionit shqiptar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E VERIFIKIMIT TË FIGURAVE

Nr. 1120/3 Prot. Tiranë, më .22.06.2026

Lënda: Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për marrjen e titullit të nderit.

KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL

Z. Eduart Duro

I nderuar z. Duro!

Në përgjigje të shkresës nr. 1763 prot., datë 13.05.2026, (tonën nr. 1120 prot., datë 18.05.2026), "Kërkesë për informacion", të Institucionit të Bashkisë Devoll drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), për verifikimin e figurës së z. Zamir Dule, kandidat i propozuar për dhënie titulli "Qytetar Nderi", bashkëlidhur do të gjeni:

Vendimin nr. 316, datë 18.06.2026 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti

8 vendime/Lig

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr.1367/19 Prot.

Tiranë, më 19.06.2026

V E N D I M

Nr.316 Datë 18.06.2026

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 18.06.2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Znj.Gentiana Sula	Kryetare
Z. Albert Nikolla	Anëtar
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Gjergj Marku	Anëtar
Z. Skënder Vrioni	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Devoll, me shkresën nr. 1763 prot., datë 13.05.2026, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Zamir Dule, kandidat i propozuar për dhënie titulli "Qytetar Nderi".

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë*".

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën për informacion të paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Devoll, me shkresën nr. 1763 prot., datë 13.05.2026, sipas objektit të saj,

V Ë R E N:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 1763 prot., datë 13.05.2026, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Devoll, në zbatim të detyrimeve ligjore që rjedhin nga Ligji nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë*", i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Zamir Dule, kandidat i propozuar për dhënie titulli "Qytetar Nderi" me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Devoll.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues, për z. Zamir Dule, nuk figuron të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 30, të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I

1.Të informojë Institucionin e Bashkisë Devoll, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 1763 prot., datë 13.05.2026, "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për dhënie titulli "Qytetar Nderi", se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë",* i ndryshuar rezulton se z. Zamir Dule:

a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat të Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Populllor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;

b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;

c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t´i dërgohet institucionit të Bashkisë Devoll.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

KRYETARJA

Dr. Genti ana Sula

ANËTAR Dr. Albert Nikolla

ANËTAR Alvin Hoxha

ANËTAR Gjergj Markut

ANËTAR Skënder Vrioni

Bilisht, 8.5.2026.

Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Verdor të Nderit në Bashkinë Devoll.

Proces - Verbal.

I mbajtur sot, në datë 08.05.2026 për shqyrtimin e kërkesës me numër 976 prot, datë 12.3.2026 të Zj. Lidita Çohani drejtuar Këshillit Bashkiak Devoll për shpalljen "Qytetar nderi" pas vdekjes të gazetarit 2.Zanin Dule. Bashkia me shkresën numër 976/1 prot, datë 29.04.2026 drejtuar Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Verdor të Nderit në Bashkinë Devoll, kërkohet të realizohet vlerësimi nga ana e komisionit këshillimor lidhur me shpalljen "Qytetar nderi" pas vdekjes të gazetarit 2. Zanin Dule.

Të pranishëm të mbledhjes janë 2. Nardi Hoxha, Zj. Elisenta Parligoti dhe Zyj. Orsela Zhulali. 2. Nardi Hoxha në rolin e kryetarit të komisionit i njeh me njoftimin e mbledhjes e komisionit Këshillimor, të ngritur me Urdhrin e kryetarit Bashkisë Devoll me numër 522, dt. 02.10.2025. Me mbledhjen 2. Oliver Topçiu dhe Zyj. Klodiana Fetahi.

Komisioni pas njohjes me kërkesën e depozituar nga Zyj. Lidita Çohani, në zbatim të nenit 11, pika 2, shkronja b) të ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt verdorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" konstaton se propozimi është hyrë në zbatim të ligjit.

Komisioni Rexhep Figuera e 2. Zanin Dule i cili ka
një përvojë gazetareve të talentuar të pas vitve 90'.
Ai e ka nisur karrierën si korrespondent për Radion e Korçës
pranë gazetës "Koha jonë" dhe për botimin e një seri librash —
ku më i njohuri është libri "Petrinjtë i Troplojës"
Ndër ngjarjet më të ersetta në karrierën e tij si gazetar
ka qenë marrja me çështje nga ambientet e vedetsisë së
gazetës "Kafja Zorë" dhe heqtrajtimi në qelitë e komisariatit
nr. 3 natën e 2 Marsit 1997, ku më pas ai pati pasoja
të rënda në shëndetin e tij rendor duke u keqtrajtuar nga
gazetaria. Në shenjë gjithnjë për vrasjen dhe sakrifikën, qenësi
Shqipëtara pas viti 1997 i kthehet një pension të pasaçën.
Në zbatim të nenit 10, pika dhjetë të Ligjit nr. 45/2015 dhe
ndërtuar nr. 94/2022 për titujt e deri dhe titujt vendore të
Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të
Shtetit nëse 2. Zanin Dule ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit
të Shtetit. Pas njoftimit të Vendimit Autoriteti për
Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Komisioni
do të mbledhet sërish për të vendosur Ridhën në mendimin
e tij të cilin do tija përcjellë autoritetit përgjegjës për
dhënien e titullit "gjytetar nderi".
Hapet votimi për të hëthuar nga Autoriteti për Informim, Informacio-
për 2. Zanin Dule.
Nardi Hoxha — Pro
Ornela Rrapo — Pro
Elinerta Paliqoti - Pro.
Mbyllet votimi, 3 vota pro, o kundër, o abstenim.

Hoxha.

Psikologja imbyllet këtu, dhe pas vështirësive të Autoritetit
të informimit mbi dokumentet e të Sigurimit të Shtetit
do shkaktojnë pë të shpëtuar mendimin tonë për 2. Luftë Bo

Nardi Hoxha

Ornela Shkëlzen

Elisenta Parligoti